

Shërbimet administrative në fushën e sigurisë publike.

1. Të sigurojë zbatimin efektiv të urdhrave të nxjerra nga kryetari i bashkisë dhe të vendimeve të këshillit që kanë të bëjnë me sigurimin e rendit e të qetësisë dhe mbarëvajtjen e punëve publike.
2. Të marrë masa për ruajtjen e pasurisë së bashkisë si dhe të atyre që administrohen nga ana e saj.
3. Të sigurojë zbatimin e urdhrave të nxjerra nga kryetari i bashkisë në lidhje me personat juridikë ose fizikë, që nuk plotësojnë konform ligjit detyrimet financiare e fiskale, ndaj bashkisë apo komunës, si dhe çdo detyrim tjetër pasuror ndaj tyre.
4. Të mbikëqyrë e verifikojë nese shtetasit në administrim të pasurisë së tyre, zbatojnë ose plotësojnë kërkesat e akteve bashkiake.
5. Të konstatojë e të parandalojë ndotjet e mjedisit, hedhjet e mbeturinave të ndryshme, si dhe të sinjalizojë kryetarin e bashkisë për shfaqjet e parazitëve të dëmshëm e të rezikshëm si dhe për rastet e shfaqjes së epidemive.
6. Të ndalojë, shmangë e prishë ndërtimet e paligjshme, të ndalojë zëniet e paligjshme të trojeve dhe të ndërtesave e objekteve publike të bashkisë si dhe të organizojë lirimimin e tyre.
7. Të kujdeset për qetësinë publike, duke shmangur zëniet, mënjanoz zhurmat e shkaktuara nga grumbullimet e njerëzve, autoparlatet e radiove e magnetofonëve, rënia pa vend e burive të automjeteve në rrugë, banesa, plazhe e mjedise të tjera publike, që sjellin shqetësime për të tjerët.
8. Të marrë masa për ruajtjen e rendit, kur ka grumbullime njerëzish, si në tregje, panairë, ceremoni publike, artistike, fetare e sportive, në kinema, teatro, pallate e salla sportive, objekte të kultit dhe në mjedise të tjera publike.
9. Të inspektoj tregjet, të kontrollojë zënien e vendeve për tregti ambulante, të verifikojë pajisjen me licensë të tregtarëve dhe personave të tjerë që merren me veprimtari shitblerje, me tregtimin e pijeve alkoolike, objekteve me vlera artistike e kombëtare, të lëndëve djegëse, të kontrolloj respektimin e masës, peshës dhe çmimin e shitjes.
10. Të kujdeset për respektimin e orarit të shërbimit të njësisve tregtare, bufeve, restoranteve, bilardove, lojrave të fatit e të objekteve të tjera me veprimari publike, si dhe për zbatimin nga ana e tyre të rregulloreve apo urdhrave të nxjerra nga kryetari i bashkisë.
11. Të kontrollojë marrjen e masave të sigurisë që parandalojnë fatkeqësitë e ndryshme natyrore si dhe të ndihmojnë në kapërcimin e tyre duke u dhënë gjithashtu ndihmë të dëmtuarve në raste urgjence.
12. Të marrë masa të përkohshme ndaj të sëmureve psikikë në gjëndje të rëndë, që krijojnë shqetësime për rendin publik.
13. Të kujdeset për ruajtjen e afisheve, njoftimeve e shpalljeve publike si dhe heqjen e atyre të paligjshme ose të paautorizuara.
14. Të kontrollojë e të marrë masa për zbatimin e rregulloreve, urdhrave e udhëzimeve të leshuara nga kryetari i bashkisë për probleme që lidhen me zbatimin e këtij ligji.